



Këshilli Prokurorial i Kosovës/
Tužilački Savet Kosova/Kosovo
Prosecutorial Council

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Nr. 2020-L/01



Ky memorandum mirëkuptimi lidhet mes Enviromentally Responsible Action (ERA) regjistruar në Prishtinë me datë 27.08.2003 dhe institucioneve më poshtë referuar bashkërisht si "Palët":

- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Komuna e Pejës;
- Komuna e Deçanit;
- Komuna e Istogut;
- Komuna e Junikut;

DUKE QENË SE, ERA ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit natyror në tërësi, ku një rëndësi të veçantë zënë të gjitha mjediset në të cilat gjenden kafshët e egra, specia e Rreqebullit të Ballkanit në Kosovë dhe habitatet e tyre.

DUKE QËNË SE, ERA ka për qëllim të përkrah menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, në respekt të plotë me legjislacionin mjedisor në Kosovë. Për të siguruar rimekembjen dhe menaxhim të mirefillët të kafshëve te egra ne vecanti Rreqëbullit të Ballkanit dhe habitatit të tyre.

PËRDERISA, Palët ndajnë misione të ngjashme dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë në fushat e interesit të përbashkët, për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të tyre për të mbrojtur mjedisin në tërësi dhe veçanërisht mjedisin në zonat e mbrojtura

ATËHERË, Palët bien dakord të bashkëpunojnë si vijon:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandum është të krijojë një kuadër bashkëpunimi midis palëve dhe të lehtësojë ndërveprimet e tyre, mbi një bazë jo-ekskluzive, në fusha të interesit të përbashkët. Palët, me anë të kësaj marrëveshjeje bien dakord të kombinojnë burimet njerëzore, financiare dhe logjistike, si dhe përpjekjet e tyre me qëllim maksimizimin e arritjes së objektivave të përbashkëta.

Ky bashkëpunim ka këto qëllime:

- a) të sigurojë një angazhim afatgjatë për ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit, habitateve të tij dhe specieve të gjahut në Kosovë,
- b) të përcaktoje natyrën e bashkëpunimit dhe përgjegjësive për të arritur objektivin e lartpërmendur,
- c) të krijohen bazat për implementimin e mëtejshëm të përbashkët të masave për ruajtjen dhe monitorimin e rrëqebullit të Ballkanit, specieve të gjahut dhe habitatit të tij.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e veprimtarive të mëposhtme:

- 2.1 **Përcaktimi respektiv i një personi kontakti**, për të koordinuar përpjekjet e përbashkëta në kuadër të këtij memorandumit. Personat e kontaktit do të përgatisin formatet përkatëse të komunikimit të ndërsjellët, duke u kujdesur për aspektet cilësore, sasiore dhe frekuencën e shkëmbimit të informacionit. Personat e përcaktuar do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin ashtu siç përshkruhet në standardet që do të vendosen në mirëkuptim midis palëve.
- 2.2 Të realizojnë **monitorimin e jetës së egër dhe veçanërisht monitorimin e Rrëqebullit të Ballkanit**, habitatit dhe presë së tij, si dhe identifikimin e habitateve potenciale të rrëqebullit në vend. Për këtë qëllim, ERA bie dakord për të vënë në dispozicion personelin, mjetet e transportit dhe materialet e punës, si dhe do të garantojnë të gjitha shpenzimet financiare të personelit të saj që do të nevojiten për të realizuar këtë aktivitet. Pala tjetër merr përsipër të sigurojë zbatimin e ligjit, si dhe të ndihmojë në ruajtjen e Rrëqebullit të Ballkanit duke lëshuar lejet dhe certifikatat e nevojshme sipas legjislationit në fuqi.
- 2.3. Të punojnë për **zhvillimin dhe zbatimin e planit të monitorimit dhe rishikimin e rrëqebullit dhe habitateve të tij**. ERA bie dakord të vërë në dispozicion të gjithë ekspertizën e saj në realizimin e këtij aktiviteti. Pala tjetër bie dakord për nevojat e ndërsjella dhe për ndërhyrjet që do të nevojiten për të plotësuar këto nevoja.
- 2.4. **Rritjen e ndërgjegjësimit në grupe të veçanta të interesit** si barinj, gjuetarë, fermerë, specialistët e pyjeve dhe publikun e gjerë mbi rëndësinë e jetës së egër, habitateve me biodiversitet të lartë si dhe rreziqet që i kanosen Parkut Kombëtar. Për këtë qëllim, palët do të bien dakord për nevojat e ndërsjella dhe për ndërhyrjet që do të nevojiten për të plotësuar këto nevoja.
- 2.5. Në rajone të caktuara të prezencës së rrëqebullit në vend të **organizojnë aktivitete të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit në Parkun Kombëtar**. Për këtë qëllim, palët, me përjashtim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, bien dakord për të vënë në dispozicion personelin, mjetet e transportit dhe materialet e punës, si dhe do të garantojnë të gjitha shpenzimet financiare që do të nevojiten për të realizuar aktivitete të tilla.
- 2.6 **Përmirësimi dhe fuqizimi i veprimtarisë si dhe aktiviteteve shkencore** mbi jetën e egër në zonat e mbrojtura dhe faktorët që ndikojnë në ruajtjen e tyre. Për këtë qëllim, palët bien dakord se në partneritet do të dizajnohet koncepti i monitorimit dhe aktiviteteve shkencore, si dhe do të implementojnë aktivitete financuar me fonde kombëtare, ndërkombëtare ose vetjake. Palët në vartësi të projektit ose aktivitetit mund të pranojnë personel nga pala homologe. Kooptimi, kryhet përmes një kërkesë zyrtare me shkrim, në të cilën parashtrohen qëllimi, afatet kohore dhe implikimet

financiare. Pala tjetër merr përsipër të përfitojë maksimalisht nga këto mundësi duke caktuar personelin e duhur për të marrë pjesë në to si dhe duke nxitur pjesëmarrjen e anëtareve të tjerë.

- 2.7 **Rritjen e kapaciteteve** të personelit të zonave të mbrojtura dhe profesionistëve që janë përgjegjës për menaxhimin e këtyre zonave. Për këtë qëllim, Palët do të bien dakord për nevojat e ndërsjella dhe për ndërhyrjet që do të nevojiten për të plotësuar këto nevoja. Me këtë rast, Palët do të mbështesin në organizimin e sesioneve trajnuese dhe mundësive të tjera të mësimit në lidhje me monitorimin e jetës së egër, promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura, etj.

Neni 3

Konsultimi dhe Shkëmbimi i Informacionit

- 3.1 Palët duhet të mbajnë rregullisht të informuar njëra-tjetrën dhe të konsultohen rreth çështjeve në interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre mund të çojnë në një përfitim të ndërsjellë.
- 3.2 Informacioni i shkëmbyer në bazë të këtij memorandumi do të trajtohet nga Palët si konfidencial (besueshëm), përveç rasteve kur ato bien dakord ndryshe.
- 3.3 Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë në kuadër të këtij Memorandumi, pa pasur dakordim midis tyre për ndarjen e informacionit.
- 3.4 Palët duhet që në intervale kohe të gjykuara si të përshtatshme të thërrasin mbledhje të përbashkëta periodike për të parë progresin e bashkëpunimit sipas këtij memorandumi si dhe për të planifikuar aktivitetet për të ardhmen.
- 3.5 Palët mund të ftojnë njëra-tjetrën të dërgojnë pjesëmarrës në takime ose konferenca të organizuara prej tyre në të cilat, sipas opinionit të njëjës palë, pala tjetër mund të jetë e interesuar.

Obligimet ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës¹ dhe ERA-së

Neni 4

Obligimet e KPK-së

- 4.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës, konform detyrave dhe përgjegjësive të tyre merr për obligim caktimin e një prokurori koordinator për rastet e mbrojtjes së ambientit dhe mjedisit natyror për Prokurorinë Themelore në Pejë.
- 4.2 Lëndët e kësaj natyre do të trajtohen me prioritet nga ana e prokurorëve konform detyrave dhe përgjegjësive që i kanë.

¹ Në tekstin e mëtejshëm KPK.

Neni 5 **Obligimet e ERA-së**

ERA në kuptim të misionit të tyre merr për obligim raportimin e veprimtarive ilegale të cilat përbëjnë vepra penale, tek prokurori koordinator i mbrojtjes së ambientit dhe mjedisit natyror në Prokurorinë Themelore në Pejë ose prokurori kujdestar i kësaj prokurorie.

Neni 6 **Zbatimi i Memorandumit**

- 6.1 Asnjë Palë nuk mund të jetë agjent ose përfaqësues i Palës tjetër, përveç rasteve kur përcaktohet me autorizime të posaçme. Asnjë nga Palët nuk duhet të hyjë në ndonjë marrëveshje ose të lidhë kontratë në emër të Palës tjetër dhe duhet të jetë vetë përgjegjëse për shpenzimet që parashikohen në këtë Memorandum dhe në kontratat për bashkë-financim të përfunduara në përputhje me të. Të dhënat që do të gjenerohen në kuadrin e bashkëpunimit nuk mund të përdoren nga secila prej palëve në asnjë formë që i shkakton konkurrencë palës tjetër.
- 6.2 Secila Palë është përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet në lidhje me këtë Memorandum dhe zbatimin e saj.

Neni 7 **Vizibiliteti**

Palët pranojnë që masat e bashkëpunimit do të bëhen zyrtare dhe publike dhe bien dakord të njohin rolin dhe kontributin e secilës në deklaratat për shtyp, dokumentat e informacionit publik dhe zyrtar në lidhje me aspektet e këtij bashkëpunimi, dhe të përdorin emrin dhe emblemat e secilës palë në dokumentet që lidhen me bashkëpunimin.

Neni 8 **Kohëzgjatja, Përfundimi, Ndryshimi**

- 8.1 Bashkëpunimi i propozuar në këtë Memorandum nuk është ekskluziv dhe do të ketë një afat të pa përcaktuar, përveç kur shfuqizohet nga secila palë nëpërmjet një njoftimi me shkrim palës tjetër një muaj përpara.
- 8.2 Në rast të përfundimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, kontratat për bashkë-financim në zbatimin e aktivitetetve dhe projekteve të përbashkëta, dhe çdo dokument tjetër i miratuar në bazë të kësaj marrëveshje mund gjithashtu të perfundojë në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes në fjalë. Në këtë rast, Palët duhet të ndër marrin hapat e duhur për të siguruar që aktivitetet e zbatuara në kuadër të këtij memorandumi mirëkuptimi, kontratat e bashkë-financimit dhe dokumentacionet përkatëse janë konkluduar në kohë dhe siç duhet.
- 8.3 Kjo marrëveshje mund të amendohet me shkrim vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve.

Neni 9
Njoftimet dhe adresat

Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet ose të bëhet sipas këtij Memorandumi duhet të jetë me shkrim ose përmes postes elektronike zyrtare të palëve. Një njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë do të konsiderohet i/e dhënë ose i/e bërë siç duhet kur ai/ajo i dorëzohet personalisht Përfaqësuesit ligjor të palës respektive, ose kur i dërgohet përfaqësuesit të autorizuar të cilit i drejtohet palës në fjalë në adresën e specifikuar me poshtë. Përfaqësuesi i autorizuar për secilën Palë respektivisht do të jetë:

Për ERA:	
Email:	kastrati.ilirjana@outlook.com/ jana_peja@hotmail.com
Tel	+383 49205334
Për këshillin prokurorial	
Email	arben.hoti@rks-psh.org
Tel	+383 45292915
Për Komunen e Pejes	
Email	kastriotbelegu@gmail.com
Tel	+383 45894000
Për Komunen e Deqanit:	
Tel	
Email	
Për Komunen e Istogut:	
Email	hekurani.rugova@rks-gov.net
Tel	+383 44189735
Për Komunen e Junikut	
Email	Leonardi_87@gmail.com , leonard.llofuni@rks-gov.net
Tel	+383 49760282

Neni 10
Të ndryshme

Dështimi i secilës prej palëve në zbatimin e ndonjë dispozite të këtij Memorandumi nuk do të përbëjë heqje dore prej saj ose prej ndonjë dispozite tjetër të Marrëveshjes. Pavlefshmëria ose moszbatueshmëria e ndonjë prej dispozitave të këtij Memorandumi nuk sjell pasoja mbi vlefshmërinë ose moszbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër.

Neni 11
Hyrja në Fuqi


Ky Memorandum nënshkruhet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në origjinal. Secila prej këtyre kopjeve përbën një origjinal dhe të ekzekutuara siç duhet përbejnë një

dokument të vetëm. Memorandumi do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është nënshkruar siç duhet nga të dy Palët.

Pejë: 30.06.2020

Environmentally Responsible Action


Pejë: 30.06.2020



Këshilli Prokurorial i Kosovës


Pejë: 30.06.2020

LEONULLA GORRIJPEVCI




Komuna e Pejës

Pejë: 30.06.2020




Komuna e Deçanit

Pejë: 30.06.2020



Komuna e Istogut

Pejë: 30.06.2020



Komuna e Junikut

Pejë: 30.06.2020

